



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë-Ministarstvo Obrazovanja Nauke i Tehnologije- Ministry of Education, Science and Technology

Akreditimi dhe Licencimi i Bartësve Privat të Arsimit të Lartë

Qeveria e Kosovës ka kërkuar nga Këshilli Britanik për Akreditim të zhvillojë projektin e akreditimit të Arsimit të Lartë Privat, duke pasur parasysh Ligjin e Kosovës, standardet ndërkombëtare dhe procesin e Bolonjës.

Këshilli Britanik për Akreditim (KBA) është formuar në vitin 1984 dhe është i akredituar nga Zyra Britanike për Standarde të Arsimit (OFSTED) i cili akrediton institucionet e pavarura të arsimit të lartë dhe atij superior.

Është anëtar i Rrjetit Ndërkombëtar të Agjencioneve për Vlerësim të Cilësisë të Arsimit të Lartë (INQAAHE), që është organi kryesor botëror për konsultime ndërkombëtare në lëmin e akreditimit të arsimit të lartë.

Bartësit Privat të Arsimit të Lartë të cilët kanë aplikuar për akreditim dhe rilicencim janë:

1. Akademia “Evolucion”
2. Akademia e Arteve
3. Akademia Evropiane “Teuta”
4. Akademia për Teatër, Film, TV & Radio
5. Akademia për Studime të Avancuara Universitare “ASAU”

6. American University of Kosova
7. Fakulteti i Ekologjisë "Ekoman"
8. Fakulteti i Farmacisë
9. Instituti "Katana"
10. Instituti "Nic-Holding"
11. Kolegji për Edukim Sportiv "Eurosport"
12. Kolegji Universitar "Ameri-kos"
13. Kolegji Universitar "Fama"
14. Kolegji Universitar "Tempulli"
15. Kolegji Universitar "Universum"
16. Kolegji Universitar "Victory"
17. Kolegji Universitar "Vizioni Evropian"
18. Kolegji Universitar "Biznesi"
19. Kolegji Universitar i Ferizajit "KUF"
20. Kolegji Universitar i Gjilanit
21. Shkolla e Dizajnit "Design Factory"
22. Universiteti "AAB" (Arena e Arsimit Bashkëkohor)
23. Universiteti "Dardania"
24. Universiteti "Iliria"
25. Universiteti "Pjetër Budi"
26. Universiteti "Riinvest"
27. Universiteti Evropian në Kosovë
28. Universiteti i Prizrenit
29. Universiteti i Shkencave Mjekësore "Rezonanca"
30. Universiteti Internacional i Prishtinës
31. Universiteti për Biznes dhe Teknologji "UBT"

Këshilli Britanik për Akreditim (KBA) ka bërë inspektimin e objekteve, intervistimin e stafit udhëheqës dhe ka analizuar një numër të konsiderueshëm të materialeve që janë dorëzuar nga ana e këtyre institucioneve.

Bazuar në faktet e nxjerra nga këto materiale, asnjë nga Bartësit Privat të Arsimit të Lartë (BPrAL) në Republikën e Kosovës (përveç Universitetit Amerikan në Kosovë) aktualisht nuk i përmbushin kriteret për tu akredituar ose licencuar për të ofruar grada akademike. Ekipi po ashtu ka konstatuar se, institucionet të cilat kanë aplikuar duke përdorur nomenklaturën si Akademi, Fakultet, Institut, etj, nuk mund të rekomandohen për akreditim si të tilla.

KBA shpreh brengosjen për:

- vartësinë e këtyre institucioneve nga një apo disa persona kyç;
- proporcionin e lartë të stafit në marrëdhënie jo të rregullt pune (part-time) dhe ndikimin e këtij proporcioni dhe përkushtimit të tyre në stabilitet të institucionit dhe
- sistemin e pakonsoliduar për sigurimin e cilësisë.

Inspektorët e KBA po ashtu kanë konstatuar se janë aplikuar:

- Qëndrime dorë-lira në dhënien e titujve akademik;
- Programe të studimit që kanë përqendrim të tepruar ndaj drejtimeve të Drejtësisë dhe Ekonomisë, gjë që nuk përkon me nevojat e tregut të Kosovës;
- Testime dhe vlerësim i dobët i cilësisë;
- Mos-trajtimi i nevojshëm i shkallës së ulët të përfundimit të studimeve.

Përveç rekomandimeve të përgjithshme, raporti i KBA përmban edhe raportet individuale për secilin nga BPrAL. Raportet individuale paraqesin përshkrime përmbledhëse të gjendjes së BPrAL, bazuar në inspektimin e institucioneve dhe përkrahen fuqishëm nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vet këto institucione.

Në bazë të rekomandimeve nga KBA se asnjëri nga Bartësit Privatë të Arsimit të Lartë (BPrAL) nuk i plotëson kushtet për akreditim dhe licencim, Qeveria e Kosovës ka sjellë [vendim](#) që asnjëri nga këta BPrAL të mos akreditohet e as licencohet. Rjedhimisht, është sjellë edhe vendimi që asnjëri nga këta BPrAL të

mos pranojë studentë derisa të kryhet edhe akreditimi i dytë (i paraparë për vitin e ardhshëm akademik).

Kjo nuk do të thotë se do të kërkohet nga këto institucione të mbyllen tërësisht. Ekipi i inspektorëve ka gjetur programe të vlefshme në aspektin e specializimeve dhe shtrirjes gjeografike dhe ka rekomanduar krijimin e Këshillit Kosovar të Gradave Akademike (KKGA), i cili do të mund të lëshojë diploma, certifikata dhe tituj akademik bazuar në mësimdhënie dhe vlerësimin në BPrAL.

Ky raport gjithashtu rekomandon që, Qeveria e Kosovës të punojë me Institucionet e Arsimit të Lartë Privat dhe me KKGA-në që të zhvillojë forma adekuate të qeverisjes për të përmirësuar kualitetin e arsimit që ofrojnë këto institucione në dobi të shoqërisë.

Më tutje, rekomandimet në këtë raport janë bërë për të përmirësuar rregulloren për arsim të lartë, teknik dhe profesional në Kosovë, në mënyrë që sigurohet një sektor privat i cili do të jetë i klasit dhe cilësisë së lartë për vitet në vijim.

MASHT do të punojë me BPrAL për të siguruar një proces të sigurt drejt kualifikimeve valide dhe të respektuara në nivel qendror. Kjo do tu mundësonte institucioneve më të mira të punojnë drejt statusit të tyre autonom gjatë viteve në vijim.